

# **STATUTI I SHOQËRISË DHE AKTI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "Media Ditari Initiative" Sh.p.k**

Në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, ne themeluesit:

**Erald Kapri**, i biri i Izja, lindur në datë 14/05/1987, në Pogradec, banues në Tiranë, dhe mbajtës i letërnjoftimit me nr. I70514075F, në cilësinë e ortakut themelues krijon:

Shoqerinë me përgjegjësi të kufizuar "Media Ditari Initiative" Sh.p.k, me seli në ruga Bardhok Biba, ish Kinema 17 Nëntori, ambient komercial, katë 2, me nr. Pasurie 6/ 150-N27, Zona Kadastrale 8360, Tiranë, Shqipëri.

Statuti është akti bazë ku do të mbështetet themelimi i shoqërisë tregtare "Media Ditari Initiative" sh.p.k, si dhe zhvillimi i mëtejshëm i saj.

## **KREU I NENI 1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Ortaku i vetëm i kësaj shoqërie, është shtetasi Erald Kapri, i cili zoteron 100 % të kapitalit të kësaj shoqërie.

## **NENI 2 EMËRTIMI I SHOQËRISË**

**2.1.** Shoqëria mban emrin "Media Ditari Initiative" sh.p.k, dhe është person juridik shqiptar.

**2.2.** Kjo shoqëri e fiton personalitetin e saj juridik, me regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**2.3.** Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në këtë akt.

## **NENI 3 SELIA E SHOQËRISË**

**3.1.** Shoqëria "Media Ditari Initiative" sh.p.k, ka qendrën në adresën në ruga Bardhok Biba, ish Kinema 17 Nëntori, ambient komercial, katë 2, me nr. Pasurie 6/ 150-N27, Zona Kadastrale 8360, Tiranë, Shqipëri, dhe ka të drejtë për të hapur degë dhe zyra të përfaqësimit të tjera, në Shqipëri dhe jashtë saj.

**3.2.** Njësitë strukturore, degët dhe përfaqësítë e saj do të ndërtohen konform legjislacionit shqiptar në fuqi dhe me atë të vendeve të tjera ku ajo mund të hapë degë.

## **NENI 4 OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

**4.1.** Qëllimi i shoqërisë është: Veprimtari në fushën e mediave online, prodhim, transmetim të informacioneve. Botime të ndryshme online, përfshirë revista, gazeta, fletëpalosje, printime të ndryshme, reklama, banner sticker, auditime, konsulencia e trajnim të gazetarëve, fotoreportereve në fushën e medias elektronike dhe asaj të printuar. Auditime e trajnime për gazetarinë multimediale. Shërbime të ndryshme për të gjithë llojet e informimit, organizim evenimentesh, prodhim dhe tregtim materialesh promocionale, konsulencë në marrëdhënie publike. Trajnim, këshillim në fushën e inovacionit, teknologjisë dhe në fusha të ngjashme me to. Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari tjetër ekonomike që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të shoqërisë dhe që nuk bie ndesh me legjislacionin Shqiptar në fuqi

**4.2.** Shoqëria mund të hapë gjithashtu zyra dhe degë në çdo vend tjetër në botë ku do ta ketë të mundur, apo të përmbushë të gjitha levizjet tregtare, industriale, financiare, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme të nevojshme, ose që konsiderohen të dobishme për arritjen e qëllimit të saj: mund të kontraktojë kredi dhe financim në përgjithësi, mund të marrë përsipër interesa të tjera, kuota/ aksione, pjesëmarrje në kapitalet e shoqerive të tjera apo dhe kompani të cilat kanë aktivitet tjetër social direkt apo indirekt, pa pasur për qellim vendosjen tek palët e treta.

**4.3.** Aktivitetet e sipërpërmendura do të realizohen duke respektuar legjislacionin shqiptar në fuqi dhe konform me programin e aktivitetit ekonomik dhe financiar, të miratuar nga Ortaku/Ortakët e saj.

**4.4.** Shoqëria mund të zgjerojë ose kufizojë fushën e veprimtarisë së saj në çdo kohë.

## **NENI 5 PËRGJEGJËSIA E ORTAKËVE TË SAJ**

**5.1.** Pjesëmarrja në shoqëri nuk pengon pavarësinë ligjore, organizative dhe të pronësisë së ortakëve të saj.

**5.2.** Ortakët e kësaj shoqërie, nuk janë përgjegjës për detyrimet që lindin gjatë aktivitetit tregtar të shoqërisë, tej kapitalit themeltar të saj, që vetë ata e kanë nënshkruar. Gjithashtu shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet personale të ortakëve të saj.

## **NENI 6 KOHEZGJATJA**

**6.1.** Shoqëria do të ushtroje aktivitetin ekonomik të saj, për një periudhë kohe të pakufizuar nga data e regjistrimit të saj.

## **NENI 7 SIMBOLET E SHOQËRISË**

**7.1.** Shoqëria do të ketë vulën e saj "Media Ditari Initiative" sh.p.k.

## **KREU II**

## **NENI 8**

## **KAPITALI I SHOQËRISË**

**8.1.** Kapitali i nënshkruar i shoqërisë "Media Ditari Initiative" sh.p.k përbëhet nga para me vlerë të barabartë me 1.000 (një mijë) lekë, e barabartë me 1 kuotë/pjesë me vlerë nominale 1.000 lekë, (1 kuotë/pjesë e barabartë me 100 % të kapitalit).

**8.2** Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

**8.3** Ortaku/ët përgjigjet/n për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

## **NENI 9 TRANSFERIMI I KAPITALIT DHE I KUOTAVE**

**9.1.** Kapitali themeltar ose pjesë të veçanta të tij, janë të transferueshme nga ortaku tek të tretët. Transferimi i kapitalit apo pjesëve të tij nga Ortaku në favor të të tretëve, kryhet gjithnjë me akt juridik të posaçëm. Kuotat e shoqërisë mund të pjestohen për shkak të kalimit të tyre, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

**9.2.** Shoqëria mund të zmadhojë kapitalin themeltar ose mund ta zvogelojë atë, por në çdo rast jo nën kufirin e përcaktuar ligjor. Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit behet me

vendim të ortakëve të shoqërisë dhe sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

**9.3.** Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe në shërbime, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute në natyrë sipas kërkesës së administratorit.

**9.4.** Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të ortakëve të shoqërisë në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.

**9.5.** Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar.

## **NENI 10** **TRANSFERIMI I KUOTAVE**

**10.1.** Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

**10.2.** Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

**10.3.** Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të kuotave në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

**10.4.** Kalimi i kuotave kushtëzohet nga e drejta e parablerjes së tyre, nga ortakët e tjerë të shoqërisë.

## **KREU III** **NENI 11** **ORGANI VENDIMMARRËS**

**11.1.** Asambleja e kësaj shoqërie është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë, që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë. Ortaku do të ketë të drejta vote në përpjestim me përqindjen e kontributit të zotëruar prej tij në kapitalin e Shoqërisë dhe që përfaqësohet nga Kuota e tij ose pjesë e Kuotës së tij.

**11.2.** Ortaku/ët i/e saj, vendosin për çështje si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërbllimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;

- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve;
- g) ndryshimin e statutit, e selisë së shoqërisë, hapjen dhe mbylljen e filialeve të saj.
- h) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë;
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë etj.

**11.3.** Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku/ët i/e saj duhet të regjistrohen në regjistrin e vendimeve, të dhënat e të cilit, nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Në regjistrin e vendimeve, duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- d) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

**11.4.** Shoqëria nuk mund t'i kundërshtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

**11.5.** Asambleja e Pergjitheshme do te mbahet ne seline e Shoqerise ose ne cdo vend tjeter brenda ose jashtë Shqiperise ku Ortaket mund te bien dakord. Vendi i perzgjedhur, data dhe ora si dhe rendi i dites dhe dokumentat perkatese ne lidhje me mbledhjen duhet t'i njoftohen Ortakeve me ane te postes se regjistruar ose emailit te pakten 7 dite perpara dates se percaktuar per maledhjen.

**11.6.** Per cdo vendim te marre jashtë Shqiperise nje vendim i shkruar duhet t'i dergohet Administratorit te Shoqerise. Ne rastet kur Asambleja nuk eshte mbledhur sipas ketij Neni, atehere Asambleja mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe Ortaket jane dakord.

**11.7.** Çdo Ortak ka te drejte te perfaqesohet me prokure ne perputhje me Ligjin per Shoqerite Tregtare. Çdo Ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhje nepermjet mjeteve te komunikimit ne distance sic telekonferencat dhe/ose videokonferencat, etj.

**11.8.** Ortaket pranojne dhe jane dakort per te vendosur duke shprehur voten edhe ne menyre te shkruar nepermjet qarkullimit te dokumentit te shkruar. Draft vendimi se bashku me rendin e dites dhe njoftimin dhe dokumentat mbeshtetese duhet t'i dergohet Ortakeve me poste, email ose mjete elektronike te sigurta te pakten 7 dite perpara dates se mbledhjes. Ortaket kane te drejte te miratojne vendimin duke derguar nje kopje te nenshkuar te projekt-vendimit tek Administratoret ne daten ose perpara dates se mbledhjes. Ortaket te cilet votojne kunder duhet te shprehin kundershtite e tyre per vendimin ne nje dokument me shkrim dhe duhet ta dergojne ate tek Administratori. Vendimi do te konsiderohet i miratuar nese kuorumi dhe shumica e kerkuar ne perputhje me kete Statut jane permblushur.

**11.9.** Çdo Ortak ka te drejten te votoje ne perputhje me, dhe ne proporcion me vleren nominale te Kuotes se zoteruar prej tij ne kapital.

**11.10.** Vendimet e me poshtme do te merren me nje kuorum pjesemarrjeje prej me shume se ½ e kapitalit te Shoqerise qe duhet te jete i pranishem ne mbledhje dhe do te



miratohen me voten ne favor nga ortaket qe zoterojne te pakten 70% te kapitalit te Shoqerise, i pranishem ne mbledhje:

- a. vendimet ne lidhje me mos shperndarjen e fitimeve apo/dhe me destinacionin e ndryshem te fitimeve te Shoqerise;
- b. ndryshimi i Statutit i cili nuk lidhet me objektin e Shoqerise;
- c. zmadhimi i kapitalit me nje vlore nen 3 (tre) milion Euro ose zvogelimi i kapitalit te Shoqerise.

## NENI 12 ADMINISTRATORI

**12.1.** Administratori i shoqërisë "Media Ditari Initiative" sh.p.k. është z. **Erald Kapri**, i biri i Izja, lindur në datë 14/05/1987, në Pogradec, banues në Tiranë, dhe mbajtës i letërnjoftimit me nr. I70514075F

**12.2.** Administratori i shoqërisë do të ushtrojë kompetencat e administrimit për një afat 5 vjeçar, me të drejtë ripërtëritje bazuar në nenin 95/1 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

**12.3.** Administratori i kësaj shoqërie ka të drejtë që, në ushtrim të kompetencave të administratorit, që të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme pranë çdo institucioni privat apo publik, si dhe të marrë të gjitha vendimet në interes të shoqërisë.

**12.4.** Administratori i shoqërisë mund të caktohet edhe një person tjetër, jashtë ortakut.

**12.5.** Afati i emerimit per Administratorin eshte 5 (pese) vjet me te drejte rinnovimi. Çdo ndryshim i mepasshem ne lidhje me numrin ose personin e Administratorit/reve, nuk do te konsiderohet si nje ndryshim Statuti.

## NENI 13 KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATORIT

**13.1.** Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ai vete.
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset pér mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- c) te përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet pér shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente pérpara ortakut të shoqërisë.
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur pér rr Ethanat, që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin pér Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportojë pérpara ortakut në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë pér veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

**13.2.** Administratori është i detyruar të thërrase mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme edhe në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.



**13.3.** Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjithë personave fizikë e juridikë, publike dhe/ose privatë vendas apo të huaj, autoritetetëve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve.

**13.4.** Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrëthanat me përjashtim të kompetencave që ligji i'a jep shprehimi shpeshish ortakëve.

**13.5.** Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj. Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretë e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretë nuk mund ta injoronin këtë akt në rrëthanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

#### **NENI 14 VITI FINANCIAR**

Viti finanziar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllt më 31 Dhjetor.

#### **NENI 15 BILANCI I SHOQËRISË DHE DIVIDENTET**

**15.1.** Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit finanziar, Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, e përberë nga ortakët e shoqërisë miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

**15.2.** Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, e përberë nga ortakët vendos rrëth shpërndarjes së dividentit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm finanziar, siç edhe parashikohet nga ligji.


#### **NENI 16 MBARIMI I SHOQËRISË**

**16.1.** Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakeve të shoqërisë;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtar për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar;
- d) me vendim të gjykatës;

**16.2.** Në këtë rast ortakët e shoqërisë marrin vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe duke shënuar në çdo dokument të shoqerise emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

**16.3.** Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.



**16.4.** Nëse ortakët e shoqërisë nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**NENI 17**  
**TRANSFORMIMI I SHOQËRISË**

**17.1.** Transformimi i shoqërisë bëhet me vendim të ortakëve të shoqërisë ose kur ekzistojnë faktorë të jashtëm detyrues ligjor. Në këto raste vendimi merret pasi administratori të ketë paraqitur një raport mbi gjendjen e shoqërisë.

**17.2.** Çdo transformim i bërë në kundërshtim më këtë nen është i pavlefshëm.

**NENI 18**  
**BAZA LIGJORE**

**18.1.** Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

**18.2.** Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar, Kodit Civil dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të dalë në zbatim të tyre në Republikën e Shqipërisë.

**NENI 19**  
**MOSMARRËVESHJET**

**19.1.** Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lind midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të tentohet të zgjidhen me konsensus dhe mirëkuptim.

**19.2.** Në rast të kundërt, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

**NENI 20**  
**DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

**20.1.** Ky statut është hartuar me vullnetin e lirë dhe të plotë të ortakëve të shoqërisë dhe është nënshkruar prej tyre

**20.2.** Ky Statut u redaktua në gjashtë kopje, në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë juridike. Një kopje mbahet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

Tiranë, më datë 03.05.2023

**ORTAKU THEMELUES  
TË SHOQËRISË "MEDIA DITARI INITIATIVE" SH.P.K.**

Erald KAPRI

